



Pranimi / Ditezimi / Prilipim / Pristup / Recepcion / Dohovny	12. 08 2022	2	viti god year
Organ / Njësia / Organ / Jediniца / Organi	No / Prot / Pr. / Prot. No.	Shtypja / Printog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMBHXK	4695/2022		116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.533/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në aktgjykimin A.nr.2498/2021 të datës 01.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.533/2021 të datës 14.06.2021, të parashtruar nga grup ankuesish

dhe kundër njottimit për përcaktimin e statusit të zyrtarëve publikë në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës-deklarim i statusit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.08.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.533/2021 e datës 14.06.2021 e parashtruar nga ankuesit**

dhe

**dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.**

**II. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj deklarin e statusit të ankesave të datës 20.05.2021 dhe në pajtim me dispozitat ligjore të lëshoj akt administrativ lidhur me deklarinim/rregullim e statusit të ankuesve.**

**III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.**

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Ankuesit

dhe

të punësuar në, më datë 14.06.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 20.05.2021 për përcaktimin e statusit të zyrtarëve publikë në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, me pretendimin ankimor së nuk janë marrë parasysh karakteristikat e veçanta që ka sigurimi në ASHNA.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 29.06.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ndërsa Këshilli me datë 19.07.2021 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Në mungesë të kuorumit për vendosje, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Njoftimit me numër protokollit 3961/2021 të datës 28.07.2021, ka njoftuar ankuesit lidhur me arsyen e mos vendosjes së ankesës duke udhëzuar të njëjtit mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datë 01.07.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2498/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve tani ankuesve, duke anuluar njoftimin e datës 28.07.2021 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesve A.nr.533/2021 të datës 14.06.2021.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3047/2022 të datës 14.06.2021 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2498/2021 të datës 01.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative Flete kthesën e datës 03.08.2021; Njoftimin me numër protokollit 3961/2021 i datës 28.07.2021; E-mail nga D.U. për F.L. etj. i datës 20.05.2021; E-mail [info.dmzpz@rks-gov.net](mailto:info.dmzpz@rks-gov.net) gjegjësisht nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë i datës 19.05.2021 lidhur me deklarimin e statusit të zyrtareve të ASHNA-së; Tabelën e bashkangjitur lidhur me deklarimin statusin e zyrtarëve publikë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.06.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 19.07.2021; Akt Emërimin me numër protokollit 0206 të datës 19.04.2017 dhe përshkrimin e detyrave të punës të datës 05.10.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0205 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 30.10.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0203 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 02.10.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0202 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 01.10.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0201 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 23.09.2015, Akt Emërimin me numër protokollit 02-0330 të datës 07.06.2018 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 13.06.2018; Akt Emërimin me numër protokollit 0198 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 23.08.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0197 të datës 19.04.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 01.11.2015; Akt Emërimin me numër protokollit 0200 të datës 19.04.2017 së bashku me

përshkrimin e detyrave të punës të datës 22.09.2015; Akt Emërimit me numër protokoll 2/0341 të datës 10.08.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit me numër protokoll 2-0344 të datës 10.08.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit me numër protokoll 2-0342 të datës 10.08.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimit me numër protokoll 2-0343 të datës 10.08.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; email i datës 08.03.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ fq ½, email i datës 09.03.2021 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ fq ½ se bashku me listën e zyrtarëve, email i datës 20.05.2021 nga \_\_\_\_\_ për stafin e ASHNS- fq ½ dhe lista lidhur me deklarin e statusit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi së ankesa A.nr.533/2021 e datës 14.06.2021 është e bazuar dhe së lënda kthehet në rishqyrtim dhe vendosje, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se ankuesit janë të punësuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tutje ASHNA) rrjedhimisht ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0206 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Personel i Radioskopit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0205 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0203 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0202 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0201 të datës 19.04.2017, ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 02-0330 të datës 07.06.2018 ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0198 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Mbikëqyrës i Ndërtimit në Sigurim" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të Emërimit me numër protokoll 0197 të datës 19.04.2017 ushtron pozitën "Mbikëqyrës i Ndërtimit në Sigurim" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 0200 të datës 19.04.2017 Mbikëqyrës i Ndërtimit në Sigurim" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 2/0341 të datës 10.08.2017, ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 2-0344 të datës 10.08.2017 ushtron pozitën "Personel i Radioskopit" në Divizionin për Siguri, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 2-0342 të datës 10.08.2017 ushtron pozitën "Personel i Radioskopit" në Divizionin për Sigurim, ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 2-0343 të datës 10.08.2017 ushtron pozitën "Personel i Sigurimit" në Divizionin për Sigurim.

Me tej nga vlerësimi i provave materiale lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji gjen së Njësia Përgjegjëse për verifikimin e deklarin të statusit të zyrtarëve publik përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 19 maj 2021 ka përcjell në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror verifikimin e deklarin të statusit për zyrtarët publikë të kësaj agjencie, ndërsa menaxheri i Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror përmes e-mailit të datës 20.05.2021 ka njoftuar stafin lidhur me deklarin e statusit, me c' rast ankuesve

janë kategorizuar si *nëpunës administrativ dhe mbështetës*, sipas nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë së lidhur me deklarimin e statusit të tyre nuk janë marrë fare parasysh karakteristikat e veçanta që ka sigurimi në ASHNA, pasi që personeli i ASHNA-së janë pjesë e sigurimit të aviacionit civil të Republikës së Kosovës që rregullohet me Programin Kombëtar të Sigurimit të Aviacionit Civil si dhe me Aneks Rregullore dhe konventa të ICAO dhe EU. Me tej shtojnë së sigurimi në ASHNA është pjesë e sigurisë që ka të bëjë me masat fizike të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit, parandaluar hyrjen e paautorizuar në pajisje, objekte, materiale dhe dokumente dhe për ti mbrojtur ato nga një incident i sigurisë.

Kolegji i Këshillit lidhur me themelësinë e pretendimeve ankimore të ankuesve ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se institucionit e administratës publike në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë qenë të obliguara të bëjnë deklarimin dhe rregullimin e statusit të zyrtarëve publikë, siç është përcaktuar me nenin 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku thuhet se:

1. *Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

2. *Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mban një pozitë, e cila një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2 së bashku me pozitën e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji ; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë".*

5. *Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e dëgjuesit të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil.*

16. *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative.*

17. *Ndaj vendimit për deklarimin/rregullimin e statusit të punësimit mund të paraqitet ankesë, në pajtim me ligjin, në KPMSHC.*

Ndërlidhur me këtë çështje, neni 4 i Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se:

1. *Deklarimi i statusit, i të gjitha pozitave të nëpunësit civil, përveç pozitave të nivelit të lartë drejtues, bëhet në pajtim me paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 83 të Ligjit.*

2. *Deklarimi i statusit të nëpunësit civil, sipas paragrafit 1 të nenit 83 të Ligjit, bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse. Sipas vendimit, bëhen përditësimet e nevojshme në Akt Emërimit të nëpunësit civil nga institucioni ku ai është i punësuar.*

3. *Deklarimi i statusit të punonjësve, sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 83 të Ligjit bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse.*

4. Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë çdo institucioni, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore, e dërgojnë në DMZP listën e plotë të nëpunësve të cilëve duhet të ju verifikohet statusi, së bashku me dosjen përkatëse, ku përshlihen Akt Emërimi dhe kohëzgjatja e periudhës së punësimit.

5. DMZP-ja, për institucionet e administratës shtetërore, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e dokumentacionit sipas paragrafit 4, bën verifikimin rast pas rasti të plotësimit, kritereve të përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 83, të Ligjit dhe në përfundim vendos: 5.1. Deklarimin e statusit të punësimit; 5.2. Kthimin e dokumentacionit për plotësim, duke përcaktuar edhe afatin brenda të cilit duhet të plotësohen mangësitë.

6. Në rastin e përcaktuar në paragrafin 5.2 të këtij neni, DMZP-ja, bën deklarin e statusit të punësimit brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e dokumenteve plotësuese.

7. Gjatë vendimmarrjes për deklarin e statusit, zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Rrjedhimisht në kuptim të dispozitave ligjore si me lart, Kolegji duke u bazuar edhe në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka konstatuar së organet përgjegjëse gjegjësisht Zyra e personelit të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Civil dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e përcaktimit të statusit të zyrtareve të SHNA-së nuk kanë shqyrtuar të gjitha faktet dhe rrethanat që janë relevante lidhur me deklarin dhe rregullimin e statusit të zyrtareve publikë përkatësisht sipas provave të lëndës rrjedhë së deklarimi i statusit për zyrtaret e ASHNA-së është bazuar vetëm në listën e pagave, fakt ky që sipas vlerësimit të Kolegji është i pamjaftueshëm për përcaktimin dhe zgjidhjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje.

Po ashtu lidhur me deklarin e statusit të ankuesve, Kolegji ka konstatuar se njësia përgjegjëse se me rastin e rregullimit të statusit të ankueseve, nuk ka lëshuar vendim siç përcaktohet me nenin 83 paragrafi 17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, rrjedhimisht sipas nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është paraparë se: *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

Andaj, nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, njësia përgjegjëse është e obliguar që në ri procedurë të eliminojnë shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të fakteve të nxjerrin akt administrativ lidhur me deklarin e statusit të ankuesve në pajtim me Ligjin Nr.05/L-0310 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.


Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-

Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.533/2021**

**Avdyl BEKTESHI**  
  
**Procesmbajtës**

**Ardita Haxhnikaj DEMI**  
  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesve:*
- *Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative*
- *Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror ; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

